



Dokumentim rasti – fletë informacioni

Qendra vëzhguese zvicerane për të drejtën e të huajve dhe për azil (SBAA) është një organizatë e pavarur nga shteti dhe angazhohet për të drejtat e të ikurve dhe të migrant:eve.

Përse jemi të interesuar në përvojën tuaj?

Të ikurit dhe migrant:et në Zvicër kalojnë nëpër proceduara të ndryshme (procedurë azili, bashkim familjar, etj.). Këto shpesh janë të ndërlikuara dhe jo gjithmonë të drejta. Ne jemi të interesuar në përvojat që të ikurit dhe migrant:et bëjnë gjatë këtyre procedurave. Ne grumbullojmë raportimet, përpilojmë dokumentimin e rastit dhe i publikojmë këto. Ne informojmë politikan:et, gazetar:et dhe personat profesionistë dhe ua tërheqim vërejtjen për problemet me rastin e vendimeve juridike. Së bashku ne mund të përmirësojmë situatën e migrant:eve dhe të ikurve në Zvicër.

Çka duhet të dini dhe të bëni?



Publikimi i dokumentimit të rastit tuaj bëhet në mënyrë anonime

- Emrat ndryshohen për tu mbrojtur juve.
- Adresa dhe vendbanimi nuk do të bëhen publikë.



Për të dokumentuar rastin tuaj neve na duhen mundësisht i gjithë dokumentacioni

- Këto nuk do ti epen më tej askujt.



Me nënshkrimin e deklaratës së bashkangjitur ju pajtoheni, që...

- ...përfaqësuesi juaj juridik neve na i dërgon të gjithë dokumentacionin që ka të bëjë me rastin tuaj.
- ...ne publikojmë rastin e përvojës tuaj, pa përmendur as emrin dhe as vendbanimin tuaj.



Vetëm nëse ju dhe përfaqësuesi juaj juridik jeni të pajtimit, ne përpilojmë rastin e përvojës suaj dhe e publikojmë atë.



Ne nuk jemi këshillimore juridike dhe as avokat:e. Për këshillime juridike duhet të drejtoheni tek avokati:ja juaj.

Kontakti

Schweizerische Beobachtungsstelle für Asyl- und Ausländerrecht (SBAA)
Hallerstrasse 58
3012 Bern
Tel. 031 381 45 40
dokumentation@beobachtungsstelle.ch
www.beobachtungsstelle.ch

